



Planuar / Dorëzuar Priljefta/Prodato Received/Delivery	24.05.2023	3	viti god year
Organ / Njesia Org / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMISHCK	4403/2023		1/6



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.630/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.630/2023, të datës 12.04.2023 të parashtruar nga ankuesja kundër Vendimit me Nr. 17/4 të datës 09.03.2023 të Komisionit të Vlerësimit të Lëvizjes Brenda Kategorisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 24.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.630/2023, të datës 12.04.2023 të parashtruar nga ankuesja
- II. Shfuqizohet Vendimi me Nr. 17/4 i datës 09.03.2023 i Komisionit të Vlerësimit të Lëvizjes Brenda Kategorisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
- III. Anullohet konkursi me Nr. Reference: RN00010121 për pozitën Zyrtar i Lartë për Pesticide i shpallur më datë 13.10.2022 nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe çdo vendim tjetër që rrjedh nga ky proces.
- IV. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural më datë 13.10.2022 ka shpallur njoftimin për publikimin e konkursit me Nr. Reference: RN00010121 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Pesticide*, për lëvizje brenda kategorisë ku afati për aplikim ka qenë nga data 28.10/2022 deri më datë 04.11.2022, ku në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është përfshirë në fazat e procedurës (verifikimin paraprak dhe intervistën me gojë).

Pas përfundimit të procedurës përmes formularit të renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 01.12.2022 ankuesja ka rezultuar me 77 pikë, ndërsa kandidati tjetër në këtë proces ka rezultuar me 78.8 pikë.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 01.12.2022 lidhur me vlerësimin e saj, me datë 07.12.2022 parashtron ankesë tek Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me pretendime ankimore se me rastin e përfundimit të procedurës nuk janë shpallur rezultatet përfundimtare përveç njoftimit për kandidatin fitues si dhe kandidati fitues nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit ndërlidhur me kualifikimin profesional, ndërsa Komisioni i Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë më datë 16.12.2022 ka nxjerr Përgjigjes me Nr.4512.

Ankuesja kundër Përgjigjes me Nr.4512 të datës 16.12.2022 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me datë 13.10.2022 nëpërmjet adresës zyrtare elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar me datë 19.12.2022 dhe është protokolluar me numër 8202/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 31.01.2023 ka nxjerr Vendim A.nr.1222/2022 me të cilin ka aprovuar si të bazuar ankuesen e ankuesit duke e shfuqizuar Përgjigjen me Nr.4512 të datës 16.12.2022 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje tek i njëjti komision. ,

Komisioni i Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural më datë 09.03.2023 ka nxjerr Vendim me Nr. 17/4 përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses të datës 07.12.2022.

Ankuesja kundër Vendimit me Nr. 17/4 të datës 09.03.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me datë 07.04.2022 nëpërmjet adresës zyrtare elektronike ankesa.kpmschck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar më datë 12.04.2023 me numër protokoll 3473/2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e

Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 24.04.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Ndërsa Këshilli me datë 26.04.2023, ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Më darë 19.05.2023 Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr Vendim me numër protokolli 4359/2023 përmes të cilin ka bërë shtyrjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesi për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 3473/2023 e datës 12.04.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; E-mailin e datës 07.04.2023 dërguar nga ankuesja për ankesa.kpmschck@rks-gov.net; Vendimin me Nr. 17/4 të datës 09.03.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 3771/2023 të datës 24.04.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 3843/2023 të datës 26.04.2023; Konkursin me Nr. Reference: RN00010121 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Pesticide*; Vendimin me Nr. 4117 i datës 23.11.2022 për formimin e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë; Listën e aplikantëve; Listën e kandidatëve të aprovuar dhe refuzuar; Renditjen përfundimtare të kandidateve të datës 01.12.2022; Ankesën me Nr. 4346 të datës 07.12.2022 të parashtruar nga ankuesja në Komisionin e Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë; Emailin e datës 09.03.2023 nga Arkiv MBPZHR për ankuesen; Aplikacionin e datës 28.12.2022 të ankueses; Diplomën me Nr. 302 të datës 23.01.2014; Diplomën me Nr. 110 të datës 23.06.2015; Certifikatën e vitit 2016; Certifikatën me Nr. 2016-12-1-2-1-0124; Certifikatën e datës 13.05.2013; Certifikatën e datës 21.06.2012; Diplomën e datës 11.09.2013; Certifikatën e datës 24.05.2013; Akt Emërimit të datës 20.01.2016 dhe 18.01.2017; Dokument identifikimi për ankuesen; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 19.01.2022 dhe 15.12.2020; Përgjigjen e datës 25.10.2022 nga Komuna e Lipjanit për ankuesen; Aplikacionin e kandidatit B.Q të datës 04.11.2022; Diplomën me Nr. 26 të datës 12.06.2006; Diplomën me Nr. 395 të datës 09.09.2013; Certifikatë trajnimi maj 2021; Certifikatën për periudhën 03-04.06.2015; Certifikatën për periudhën 01-02.06.2015; Certifikatën për periudhën 25-26.05.2015; Certifikatën për periudhën 11-12.05.2015; Certifikatën për periudhën 20-21.11.2013; Certifikatën e datës 01.09.2013; Certifikatën trajnimi mars 2021; Certifikatën për periudhën 21-22.04.2015; Letër Rekomandimin; Kontratë Punë për Kohë të caktuar e datës 01.05.2021; Vërtetimin me Nr. 03.112-4564 të datës 27.10.2022; ; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 30.09.2021 dhe 31.12.2020; Dokument identifikimin për kandidatin B.Q; Kontratë e punës e lidhur mes kandidati B.Q dhe NRS; Kontratë mbi vepër me Nr. 03/13 e datës 30.04.2013; Aneks për plotësimin e kontratës mbi vepër; Akt Emërimit të datës 01.10.2018; Kontratë punë për punë dhe detyra specifike me Nr. 01-112-22209 e datës 12.12.2014; Letër rekomandimin nga Universiteti i Tetovës; Vendimin për transferimin e përkohshëm të nëpunësit i datës 09.12.2020; Njoftimin e datës 10.11.2022, 18.11.2022; Njoftimin për intervistë me gojë i datës 29.11.2022; Njoftimin për kandidatin e fitues i datës 03.12.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Pesticide i datës 22.09.2022; Vendimin me numër protokolli 4359/2023 të datës 19.05.2023 të Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi se janë të bazuara pretendimet ankimore të ankueses, *sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 17/4 të datës 09.03.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, pretendon se nuk janë shqyrtuar pretendimet ankimore të ngritura në ankesën e datës 07.12.2022.

Fillimisht Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar sipas konkursit me Nr.Reference: RN00010121 të shpallur për pozitën *Zyrtar i Lartë për Pesticide* të tipit lëvizje brenda kategorisë kriteret e përgjithshme formale të konkursit kanë qenë:

- *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve Universitare-në Bujqësi, Kimi apo relevante me të paktën 240, kredi/ECTS-së apo ekuivalente me to (në rastin kur kreditë janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e diplomës Master të jetë e njëjtë apo vazhdim (specializim) i Diplomës Bachelor.*
- *Përvoja e punës: Se paku dy (2) vite përvoja pune profesionale në fushën e kërkuar për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Kolegji i Këshillit, me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses duke u bazuar në nenin 86 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative sipas detyrës zyrtare ka shqyrtuar ligjshmërinë e këtij procesi dhe ka konstatuar se konkursi me Nr.Reference: RN00010121 për pozitën *Zyrtar i Lartë për Pesticide* të tipit lëvizje brenda kategorisë është shpallur bazuar në nenin 38 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenin 8 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, konkretisht shtojcës Nr. 1/8 të kësaj rregulloreje dhe nenin 40 të Rregullores Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës të Kosovës.

Me tej bazuar në kriteret e përcaktuar me konkurs, Kolegji i Këshillit, ka analizuar dokumentacionin e aplikimit të kandidatit të përzgjedhur dhe ankueses dhe rrjedhimisht ka gjetur se kandidati B.Q posedon Diplomën me Nr. 26 të datës 12.04.2006 për përfundimin e studimeve në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Drejtimin e Biologjisë duke marr titullin Bachelor i Ekologjisë-Mbrojtjes së Ambientit me gjithsej 180 kredi, posedon Diplomën me Nr. 395 të datës 09.09.2013 për përfundimin e studimeve Master në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore në Departamentin e Biologjisë duke marr titullin Master i Shkencave të Biologjisë, kurse lidhur me kriterin e përvojës së punës ky kandidatë ka ofruar dëshmi nga të cilat rezulton se i njëjti në bazë të letër rekomandimit të lëshuar nga Shoqata Ekologjike ECO 99 ka kryer detyrën e Menaxherit të Projektit, sipas Kontratës së Punës për Kohë të Caktuar nga data 01.05.2011 deri më datë 31.03.2012 ka ushtruar detyrën e Menaxherit të Projektit-Rregullimi i Tregut të Gjëlber në Komunën e Dragashit, sipas Vërtetimit me Nr.

03.11204564 të datës 27.10.2022 të lëshuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Dragashit i njëjti është në marrëdhënie punës në këtë komunë nga data 01.10.2018 në pozitën Zyrtar për Edukim dhe Ndërgjegjësim Mjedisor. Lidhur me ankuesen Kolegji i Këshillit nga analizimi i dosjes personale të aplikimit ka gjetur se e njëjta sipas Diplomës me Nr. 302 të datës 23.01.2014 me gjithsej 180 kredi ka përfunduar studimet themelore universitare në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Drejtimin Mbrojta e Bimëve duke marr titullin Bachelor në Mbrojtjen e Bimëve, posedon Diplomën me Nr. 110 të datës 23.06.2015 me të cilën dëshmohet se ka përfunduar studimet Master në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë në Drejtimin Mbrojta e Bimëve duke marr titullin Master në Mbrojtjen e Bimëve, kurse lidhur me kriterin e përvojës së punës ankuesja ka ofruar dëshmi Akt Emërimit e datës 20.01.2016 dhe të datës 18.01.2017 me të cilën dëshmohet se është në marrëdhënie pune në Komunën e Lipjanit në pozitën Zyrtar për Zhvillim.

Bazuar në kriteret e konkursit si dhe bazuar në dokumentacionin e ofruar nga kandidati fitues dhe ankuesja, Kolegji i Këshillit, konstaton se nga shqyrtimi i dosjes së kandidatit fitues B.Q rezulton se i njëjti plotëson kriteret e konkursit për sa i përket arsimimit të kërkuar, ngase fusha në të cilën ky kandidat ka fituar arsimimin hyn në kuadër të shkencave matematike natyrore, siç hyn edhe Kimia që ka qenë kriter i konkursit dhe meqenëse ka qenë kriter edhe diploma të tjera relevante, ky kandidat ka arsimin relevant me fushën në të cilën është kërkuar në konkurs, mirëpo sa i përket përvojës së punës që është kërkuar në konkurs *së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën e kërkuar për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës*, Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të dosjes së këtij kandidati, rezulton se i njëjti përveç provave të cekura si më lartë nuk ka ofruar dëshmi me të cilën do të dëshmonte se ka përvojën e punës profesionale në fushën për të cilën është zhvilluar procedura respektivisht nuk ka përvojë pune profesionale në fushën e bimëve apo të ngjashme, ngase në bazë të formularëve të vlerësimit të rezultateve në punë të datës 30.09.2021 dhe 30.12.2020 rezulton fakti se në bazë të objektivave dhe aktiviteteve ka mbajtur ligjërata në arsimimin fillor dhe të mesën, pjesëmarrje në seminare ,tryeza dhe takime të ndryshme, përgatitjen e materialeve si dhe publikimin e materialeve Edukativo-arsimore dhe shpërndarjen e botimeve brenda institucionit, si rrjedhojë Kolegji konstaton se përvoja e punës së këtij kandidati nuk është relevante me atë që kërkohet me konkurs, mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se përfshija e tij në listën e verifikimit paraprak, është bërë në kundërshtim me kriteret e konkursit respektivisht të përvojës së punës, të ndërlidhura me nenin 8 paragrafi 2 nën paragrafi 2.1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr. 26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, konkretisht shtojcës Nr. 1/8 pika IV kërkesat e përgjithshëm formale shkronja c) dhe kriterin e përcaktuar me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës ndërlidhur me nenin 45 paragrafi 3.

Kolegji i Këshillit, bazuar në provat e lëndës, konstaton se ankuesja më datë 07.12.2022 ka parashtruar ankesë me Nr. Prot: 4346 pran Komisionit të Vlerësimit të Lëvizjen Brenda Kategorisë përmes të cilës pretendon se përzgjedhja e kandidatit është bërë pa u respektuar kriteret e konkursit respektivisht kriterit të arsimit dhe kriterit të përvojës së punës e për të cilën kërkohet njohuri të thella në fushën profesionale përkatëse. Ndërlidhur me këtë, Kolegji i Këshilli ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar me ankesë respektivisht Vendimit

me Nr. 17/4 të datës 09.03.2023 të Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, konstaton se nuk janë shqyrtuar në mënyrë të drejtë pretendimet ankimore të ankueses, ngase nuk është shqyrtuar në mënyrë të drejtë përvoja e punës e kërkuar në konkurs, në këtë kuptim vendimi i kundërshtuar me ankese është nxjerr në kundërshtim me nenin 48 dhe nenin 134 paragrafi të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës, kështu që pretendimet e ankueses janë të bazuara.

Nga të cekurat si më lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton meqë kjo procedurë anulohet si në dispozitiv të këtij vendimi, obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që të ndërmarr të gjitha veprimet për zbatim të këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.630/2023, datë 24/05/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.